



Datë: 16.04.2025

Numër Protokolli: 2765/2025

A.nr.25/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Ardita Haxhnikaj - Demi dhe Eshref Shabani -anëtare, me Ylber Fetahaj, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.25/2025 të datës 08.01.2025 të parashtruar nga ankuesit S.I, S.S, G.G, A.K, B.L, E.Ll dhe I.M, të cilët me autorizim i përfaqësonë Avokat Vigan Rogova nga Prishtina kundër organit të punësimit/Agjencisë së Shërbimit të Navigacionit Ajrore, në çështje juridike “*Kompensim material*”, në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e papabazuar ankesa A.nr 25/2025, e datës 08.01.2025, e parashtruar nga ankuesit S.I, S.S, G.G, A.K, B.L, E.Ll dhe I.M.

A r s y e t i m

Ankuesit S.I, S.S, G.G, A.K, B.L, E.Ll, dhe I.M (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesit), që të gjithë të punësuar në Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajrore, me datë 08.01.2025, përmes përfaqësuesit të autorizuar, Av. Vigan Rogova nga Prishtina, kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 46/2025 të regjistruar nën shenjen A.nr.25/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e shujtës ditore për ushqim, pagën jubilarë dhe pagën e trembëdhjetë sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 27.01.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencisë e Shërbimit të Navigacionit Ajrore, ndërsa më datë 04.02.2025, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) ka administruar këto prova: Ankesën A.me Numër Prot. 46/2025 të datës 08.01.2025, Kërkesën e datës 08.11.2024; ankesën për komisione ankesave ne ASHN te datës 09.12.2024; Vendimin me numër KA-Nr.005/2025 te datës 30.12.2024 të Komisionit për Ankesa ne ASHNA; Kopjen Letërnjoftimit të ankuesit E.Ll; S.S; G.G; A.K; B.L; S.I; I.M; Autorizimet qe gjenden ne shkresat e lendes te ankuesve për Avokatin; Përgjigjen ne ankesë te datës 04.02.2025 nga ASHNA; Akt Emërimit e datës 01.04.2017 për S.I; Akt Emërimit e datës 01.04.2017 për S.S; Akt Emërimit e datës

01.04.20217 për G.G; Akt Emërimit e datës 01.07.2018 për A.K; Akt emërimit e datës 08.09.2017 për B.L; Vendimin e datës 13.05.2022; Akt Emërimit e datës 01.04.20217 për G.G; Vendimin e datës 04.11.2024; Akt Emërimit e datës 01.04.20217 për I.M; Përgjigjen ne kërkesë te datës 01.02.2024; Listën e pagave për ankuesit;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesve, **është e pabazuar, sepse:**

Nga shkresat e lëndës rrjedhë së ankuesi S.I sipas Akt Emërimit me numër protokolli 0107 të datës 03.04.2017 mban pozitën “Specialit i Sistemit të Procedimit të të Dhënave”, ankuesi S.S sipas Akt Emërimit me numër protokolli 0105 të datës 03.04.2017 mban pozitën e punës “Udhëheqës i Divizionit të Komunikimit KOM & MET”, ankuesi G.G sipas Akt Emërimit me numër protokolli 0112 të datës 03.04.2017 mban pozitën e punës “Udhëheqës i Divizionit të Teknologjisë Informative”, ankuesi A.K sipas Akt Emërimit me numër protokolli 0328 të datës 01.06.2018 mban pozitën e punës “Udhëheqës i Divizionit të Survejit”, ankuesi B.L sipas Ndryshimit dhe Plotësimi të Akt Emërimit me numër protokolli 0215 të datës 09.09.2020 mban pozitën e punës “Specialist i Divizionit të Navigimit”, ankuesi E.Ll sipas Akt Emërimit me numër protokolli 0116 të datës 03.04.2017 mban pozitën e punës “Specialit i Sistemit të Navigimit” ndërsa sipas Vendimit me Nr. 112/24 të datës 04.11.2024 është caktuar ushtrues detyre i Udhëheqës të Divizionit për Mirëmbajtjen e Lokacioneve, dhe ankuesi I.M sipas Akt Emërimit me numër protokolli 0110 të datës 03.04.2017 mban pozitën e punës “Specialit i Sistemit të Komunikimit dhe Pajisjeve të Meteorologjisë”, të gjithë të punësuar në ASHNA.

Tutje sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesit përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 08.11.2024 i janë drejtuar me kërkesë organit të punësimit, gjegjësisht Drejtorit të Agjencisë e Shërbimit të Navigacionit Ajrore, për njohjen e të drejtës për shpenzime për ushqim gjatë punës, shpërblime jubilarë dhe të ardhura tjerë dhe kompensimi i tyre, sipas nenit 52, 54 dhe nenit 43 paragrafi 6 te Marrëveshjes se Përgjithshme Kolektivë te Kosovës, ndërsa për shkak te heshtjes administrative te organit te punësimit ankuesit më datë 09.12.2024 i janë drejtuar me ankesë Komisionit të Ankesave të ASHNA, ndërsa Komisioni i Ankesave i ASHNA më datë 30.12.2024, ka nxjerr Vendim KA.Nr.005/2024 me të cilin shpalljet jo kompetent për të shqyrtuar ankesën e ankuesve, me arsyetimin se nuk ka kompetencë të shqyrtoj rastet e nëpunësve të shërbimit civil.

Ankuesit te pakënaqur me vendimin e punëdhënësit parashtrojnë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që të aprovohet ankesa në tërësi duke ju njohur e drejta për pagesën e shpenzimeve ditore për ushqim gjatë punës, si dhe njëherit kërkojnë që të anulohet Vendimi KA-Nr.005/2024 i Komisionit për Ankesave i ASHNA.

Referuar kërkesës fillestare të ankuesve e cila ka të bëjë me njohjen e të drejtës për shpenzime për ushqim ditor gjatë punës, shpërblime jubilarë dhe të ardhura tjera dhe kompensimi i tyre, sipas nenit 52, 54 dhe nenit 43 paragrafi 6 te Marrëveshjes se Përgjithshme Kolektivë te Kosovës, Kolegji i Këshillit, marrë për bazë natyrën e çështjes në procedurë ankimore ju referua dispozitave të nenit 2 paragrafi 1 dhe 2, ndërlidhur me nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ku përcaktohet se: “1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës. 2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës;... neni 87 : Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës ” dhe

si rrjedhojë erdhi në përfundimin se dispozitat e nenit 87, të ligjit përkatës të punës gjejnë zbatim edhe në trajtimin e kësaj çështje administrative.

Andaj, referuar përcaktimeve ligjore si më sipër, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, konstaton se pretendimet ankimore të ankuesve për njohjen e të drejtës për shpenzime për ushqim gjatë punës, shpërblime jubilarë dhe të ardhurat tjera dhe kompensimi i tyre, sipas nenit 52, 54 dhe nenit 43 paragrafi 6 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës nga data e hyrjes në fuqi të saj datë 01.01.2015, është e pabazuar, ngase procedimi administrativ për periudhën kohore ka filluar tek sipas kërkesës së datës 08.11.2024, e që rezulton se kanë kaluar më shumë se tri (3) vite dhe e njëjta konsiderohet e parashkruar në kuptim të nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ndërsa sa i përket kërkesave nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, e që kanë të bëjnë me kompensimin për të punësuarit për periudhën nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshje, për njohjen e të drejtës për shpenzime për ushqim gjatë punës, shpërblimeve jubilarë dhe të ardhurat tjerë si dhe kompensimin e tyre, Kolegji i Këshillit, konstaton se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 sipas nenit 82 të saj, ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: ***“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”***, mirëpo neni 81 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, respektivisht paragrafi 1 ka përcaktuar që: *“Nga MPKK, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës”*, bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Neni 82 paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës përcakton se: *“Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit”*, mirëpo meqenëse njëri nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje është tërheq nga zbatimi i saj tre muaj para skadimit e njëjta nuk vlen nga data e tërheqjes, dhe meqenëse konstatohet se nga data 15.09.2017 Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, është tërhequr andaj Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është e zbatueshme, rrjedhimisht nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike sepse nuk është nënshkruar nga institucionet kompetente, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017. Bazuar në konstatimin e lartcekur dhe në kuptim të nenit 87 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesve për realizimin e kompensimit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës është parashkruar, ngase kanë kaluar më shumë se tri (3) vite nga dita e paraqitjes së kërkesës kështu që pretendimi i ankuesve mbi këtë bazë ligjore është i pabazuar.

Përkitazi me këtë Kolegji i Këshillit, konstaton faktin se meqë ankuesit kanë statusin e nëpunësit të shërbimit civil atëherë i vetmi organ që shqyrton ankesat e tyre ndaj veprimit apo mos veprimit të organit të punësimit është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës siç parashihet me nenin 27 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, kështu që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka kompetencë të shqyrtoj ligjshmërinë e vendimeve të Komisionit të Ankesave.

Për sa me sipër, Kolegji i Këshillit bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë Juridike: *Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.25/2025

Ylber Fetahaj

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve, Av. Vigan Rogova;
- Drejtorit të ASHNA-së
- Udhëheqësit të Personelit në ASHNA;
- Arkivit të KPMSHCK-së.